



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 29.05.2023

Nr: 156

Ora: 12:35

VENDIM

**PËR KTHIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 87, TË DEPOZITUAR NË KQZ NË DATËN 25.05.2023
NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALDEMOKRATE E SHQIPËRISË"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 29.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti zgjedhor "Partia Socialdemokrate e Shqipërisë", përfaqësuar nga z. Ilirjan Hoxha

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 540, datë 20.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Korçë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023".



BAZË LIGJORE: Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Subjekti zgjedhor “Partia Socialdemokrate e Shqipërisë”, përfaqësuar nga z. Ilirjan Hoxha ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 87 regj., datë 25.05.2023.

Në mbledhjen e datës 29.05.2023, ora 12:35, pas relativitetit të z. Elvin Lako u konstatua se kërkesa ankimore është paraqitur me të meta, pasi nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126. Konkretisht, ankimi i paraqitur në KAS nuk është shoqëruar me asnjë prove, të cilat do të ndihmonin organin administrativ procedues, në funksion të zgjidhjes së çështjes, siç parashikohet në nenin 126, pika 1, shkronja “dh” të Kodit Zgjedhor.

Në bazë të nenit 129, pika 1, të Kodit Zgjedhor, KAS për çdo kërkesë ankimore të regjistruar bën verifikimin e ekzistencës së elementeve të formës sipas nenit 126 të Kodit Zgjedhor dhe të elementeve të përcaktuara në nenin 130 të po këtij Kodi. Në kushtet kur kërkesa ankimore objekt i këtij procedimi nuk i plotëson kushtet e shkronjës “dh” të pikës 1, të nenit 126, ajo duhet t’i kthehet subjektit zgjedhor për plotësim të elementeve të formës dhe të përmbajtjes.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Kthimin e kërkesës ankimore nr. 87, datë 25.05.2023 për plotësim të elementëve të formës.
2. Seanca paraprake do të zhvillohet më datë 30.05.2023, ora 13:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit paraparak, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

U shpall sot më datë 29.05.2023.

Elvin LAKO - Relator

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Koli BELE - Anëtar